

Rritja e investimeve në Sistemet Statistikore Nacionale

Dokument mbi aplikimin e qasjes që shtrihet në tërë sistemin me qëllim të implementimit të Strategjisë Nacionale për Zhvillimin e Statistikave

Shtator 2007

Ky dokument është përgatitur nga Grupi për të Dhëna mbi Zhvillimin i Bankës Botërore dhe Sekretariati i PARIS21 me kërkesën e Këshillit Drejtues të PARIS21. Është pjesë e aktiviteteve, që kanë vazhduar pas tryezës së tretë të rumbullakët mbi Menaxhimin për Rezultatet Zhvillimore, të mbajtur në Hanoi në shkurt të vitit 2007 dhe takimit mbi rritjen e përkrahjes në fushën e statistikës, të mbajtur në mesin e takimeve të Bankës Botërore dhe FMN-së në prill të vitit 2007 në Uashington.

Përmbledhje ekzekutive

Në këtë dokument diskutohen shkurtimisht arsyet pse duhet rritur proporcionalisht investimet në Sistemet Statistikore Nacionale, dhe pastaj përqëndrohet në atë se si mund të arrihet kjo me aplikimin e një qasjeje që shtrihet në gjithë sistemin duke mësuar nga qasjet sektoriale, që janë aplikuar me sukses në shëndetësi, arsim dhe bujqësi. Në këtë dokument argumentohet fakti se pasja e një Sistemi Statistikor Kombëtar efektiv dhe efikas është esenciale për menaxhimin e rezultateve zhvillimore. Investimet në statistikë janë të nevojshme, po aq sa edhe në menaxhim financiar dhe prokurim. Sistemet Statistikore Nacionale ofrojnë të dhënat e nevojshme për hartimin e politikave, alokimin e resurseve të pakta, matjen e progresit, shfrytëzimin adekuat të ndihmës dhe monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve. Gjatë tryezës së rrumbullakët, të tretës me radhë, mbi Menaxhimin për Rezultatet Zhvillimore, që u mbajt në shkurt të vitit 2007 në Hanoi, ekipet e shteteve pjesëmarrëse theksuan që **për të qenë të suksesshëm, çdo rritje e përkrahjes në fushën e statistikës duhet të orientohet dhe të ketë lidhje direkte me strategjitë ose planet e tjera zhvillimore për uljen e varfërisë në nivel kombëtar, duhet të bazohet në strategji nacionale reale dhe të përgatitura mirë për zhvillimin e statistikave (SNZhS) dhe duhet të ketë përkrahjen e harmonizuar dhe të koordinuar të donatorëve.** Shumë shtete kanë dizajnuar ose janë duke dizajnuar strategji nacionale për zhvillimin e statistikave (SNZhS); tani duhet adaptuar një qasje që do të shtrihet në gjithë sistemin për t'i realizuar këto plane dhe strategji. Në përgjithësi, aplikimi i një qasjeje të tillë në statistikë përfshin përdorimin e SNZhS si kornizë për koordinimin në mes të sektorëve dhe të donatorëve. Qëllimi është që të arrihet një koherencë e përkrahjes, që ofrohet nga donatorët, dhe të zvogëlohen kostot e transaksionit duke caktuar objektiva dhe qëllime dhe duke vendosur mekanizma për implementim, monitorim të progresit dhe raportim. Padyshim që një strategji e mirë nacionale është një parakusht i nevojshëm për një qasje të koordinuar në zhvillimin e statistikave, por jo dhe i mjaftueshëm. Faktorë të tjerë të rëndësishëm janë:

- Pronësi dhe lidhësi i qartë i shtetit dhe i qeverisë
- Përfshirja e të gjithë donatorëve
- Integrimi i planit statistikor me planifikimin nacional dhe proceset që kanë të bëjnë me buxhetin
- Të siguruarit që SNZhS definojnë dhe ka të bëjë me gjithë sistemin e gjerë statistikor
- Të siguruarit që SNZhS identifikon rezultatet kryesore dhe parimin e 'përshtatjes ndaj qëllimit'
- Sigurimi i kapacitetit adekuat për koordinim dhe menaxhim
- Vendosja e strukturave dhe procedurave uniforme të implementimit
- Vendosja e mekanizmave adekuat të financimit.

Vetë shtetet dhe partnerët e tyre të zhvillimit do të vendosin nëse qasja që shtrihet në gjithë sistemin është e përshtatshme për nevojat e tyre, por mund të jetë e dobishme që të identifikohen kriteret, që orientojnë se kur mund të jetë e suksesshme kjo qasje. Ato janë:

- Vendet me aktivitete statistikore më pak të zhvilluara
- Vendet me potencial për të pasur ndikim të madh (ato me strategji të mirë ose plan të përcaktuar)
- Vendet, ku ka kërkesa të mëdha për përmirësimin e kapacitetit statistikor
- Vendet me kapacitet të mirë menaxhues
- Vendet e përzgjedhura si prioritare nga partnerët e zhvillimit

Me qëllim të aplikimit të qasjes së bazuar në program për implementimin e SNZhS, duhet të ndërmerren disa veprime:

- Të ofrohen udhëzime dhe materiale mbi praktikat më të mira për vendet që duan të aplikojnë këtë qasje
 - Të arrihet dakordimi për kriteret për identifikimin e vendeve, ku mund të jetë i përshtatshëm aplikimi i qasjes që shtrihet në tërë sistemin
 - Të ndihmohen vendet në përmbushjen e kriterëve të nevojshme për aplikimin praktik të kësaj qasjeje
 - Të ketë përkushtim të strukturave vendore dhe të donatorëve
 - Të zgjerohet rrethi i i statistikentëve me përvojë dhe specialistëve të tjerë, të cilët mund të ofrojnë përkrahje teknike dhe në zhvillimin e organizatës
 - Të krijohen procedura specifike për përkrahjen e vendeve me nevoja speciale, sidomos vendeve që dalin nga konflikti dhe vendeve shumë të vogla
- Në këtë kuptim, janë përcaktuar hapat e ardhshëm, që paraqiten në vijim:

1. Vazhdimi i diskutimit të nivelit të lartë në një seminar në Paris, në nëntor të vitit 2007, në takimin e nivelit të lartë të Komitetit për Asistencë Zhvillimore në dhjetor të vitit 2007, dhe në forumin e tretë të nivelit të lartë për Efektivitetin e Ndihmës, që do të mbahet në Akra, Gana, në shtator të vitit 2008.

2. Identifikimi i vendeve, ku do të ishte e përshtatshme rritja e përkrahjes në statistikë duke aplikuar një qasje të bazuar në gjithë sistemin. Të gjitha vendet duhet të inkurajohen që të shprehin interesim, por fazat e zhvillimit të këtij procesi do të varen nga kriteret e identifikuar më lart.

3. Përgatitja e materialeve udhëzuese dhe materialeve mbi praktikat e mira lidhur me atë se si mund të implementohet SNZhS duke shfrytëzuar qasjen që shtrihet në tërë sistemin. Drafti i parë do të jetë i gatshëm në mes të shtatorit, kurse drafti final në fund të tetorit të vitit 2007.

4. Takimet e subjekteve relevante në nivel shtetëror (duke përfshirë shfrytëzuesit e të dhënave, prodhuesit e të dhënave, financierët dhe donatorët potencialë). Pasi të kenë adaptuar vendet këtë qasje, PARIS21 do të punojë me to rreth realizimit të takimeve të subjekteve relevante në vend.

5. Përmirësimi i monitorimit të kapacitetit statistikor të vendeve dhe i përkrahjes në ndërtimin e kapaciteteve statistikore.

Pse duhet rritur përkrahja në fushën e statistikës në vendet në zhvillim?

Statistikat e besueshme janë të nevojshme për hartimin e politikave, matjen e progresit, dhe raportimin e rezultateve në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal. Tashmë është e dokumentuar çështja e kapacitetit të dobët statistikor dhe ndikimit që ka kjo në proceset e zhvillimit dhe në efektivitetin e ndihmës që ofrohet. P.sh. më pak se rreth 60 përqind e banorëve të Afrikës ishin përfshirë në regjistrimin e popullsisë gjatë ciklit të vitit 2000. Me afrimin e shpejtë të afatit për përmbushjen e qëllimeve të mileniumit dhe me shumë vende që janë duke u përpjekur të përmirësojnë planifikimin, buxhetimin dhe menaxhimin e tyre, ekziston një nevojë urgjente për përmirësimin e cilësisë dhe sigurimit të statistikave të besueshme.

Në tryezën e rrumbullakët të tretë ndërkombëtare mbi menaxhimin e rezultateve zhvillimore, që u mbajt në Hanoi në shkurt të vitit 2007, ekipet e vendeve pjesëmarrëse përkrahën me vendosmëri Planin e Veprimit të Marrakech për Statistika (MAPS), i cili u dakordua gjatë tryezës së rrumbullakët të dytë me radhë në vitin 2004, dhe i cili identifikoi investimet e pamjaftueshme në statistika si pengesën kryesore në menaxhimin e rezultateve më të mira zhvillimore. Gjatë tryezës së rrumbullakët të dytë dhe të tretë me radhë, si dhe gjatë takimit pasues të mbajtur në prill të vitit 2007 në Uashington, u theksua që statistikave të besueshme dhe të siguruara me kohë janë esenciale për përmirësimin e rezultateve zhvillimore dhe matjen e efektivitetit të ndihmës. Sot, ka një dakordim të gjerë rreth asaj se mënyra e vetme e besueshme dhe reale për sigurimin e të dhënave të nevojshme për përkrahjen e zhvillimit është promovimi i sistemeve statistikore efikase dhe efektive. Edhe pse komuniteti ndërkombëtar ka rol kyç në koordinimin dhe promovimin e aplikimit të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të mira, sistemet statistikore nacionale janë, dhe do të vazhdojnë të jenë, burimi kryesor i të dhënave mbi zhvillimin. Strategjitë nacionale për zhvillimin e statistikave (SNZhS), të dizajnuara si duhet, që adresojnë nevojën për të dhëna mbi prioritetet dhe ofrojnë një plan për investime në institucionet dhe infrastrukturën e nevojshme për një sistem funksional, janë element qendror i Planit të Veprimit të Marrakech. Ajo që nevojitet tani është një proces i koordinuar për të vënë këto plane dhe strategji në efekt. Duke qenë se ky plan veprimi u dakordua për herë të parë në vitin 2004 është shënuar progres i konsiderueshëm, por akoma ka shumë për të bërë. Donatorët dhe vendet në zhvillim, pjesëmarrës në Hanoi, theksuan nevojën për rritjen dhe përshtetimin e realizimit të përpjekjes së nisur në Marrakech dhe për dakordimin rreth intervenimeve që duhet të ndërmerren. **Çështja kyçe është të kalohet nga përgatitja e planeve dhe e strategjive (SNZhS ose dokumenteve të ngjashme) në implementimin e tyre.** Përkundër theksit më të madh në rëndësinë e statistikave, mungesa e kapacitetit për të krijuar, analizuar dhe shfrytëzuar statistikave akoma nuk është adresuar sa duhet nga programet e ndihmës dhe buxhetet në nivel nacional. Prandaj, një përkrahje më e madhe nevojitet:

□ Për t'i dhënë prioritet përmirësimit të kapacitetit statistikor në dialogjet në mes të donatorëve dhe vendeve të caktuara. P.sh. shtetet duhet të mendojnë se si të adresojnë pengesat, edhe në aspektin e krijimit edhe në aspektin e shfrytëzimit të statistikave, në strategjitë për uljen e varfërisë dhe politikave të tjera zhvillimore.

□ Për të ndihmuar shtetet të realizojnë strategjitë dhe planet e tyre përmes mekanizmave të koordinuar të ofrimit të ndihmës në nivel shtetëror. Me ndihmën e PARIS21, Bankës Botërore dhe bankave zhvillimore regjionale, shumë shtete kanë hartuar ose janë duke hartuar strategjitë e tyre, por prapë pak vëmendje i është kushtuar implementimit të tyre.

Përvoja tregon se ndihma e ofruar me qëllim të zhvillimit është më efektive atëherë kur donatorët punojnë së bashku dhe evitojnë projektet e fragmentuara dhe të ndara.

Që nga viti 2000, gjithnjë e më shumë asistencë i është kushtuar strategjive për uljen e varfërisë. Bashkimi i përkrahjes së donatorëve ka pasur sukses në disa vende. Në vende të tjera, janë zhvilluar programe sektoriale për të përkrahur implementimin e strategjive nacionale në sektorët kyç si shëndetësia, arsimi dhe bujqësia. Megjithatë, deri vonë, këto qasje nuk janë aplikuar shumë në investimet në kapacitetin statistikor. Pjesëmarrësit e takimit në Hanoi dhe Uashington theksuan që **për të qenë të suksesshëm çdo përkrahje shtesë në statistikë duhet të orientohet dhe të ketë lidhje direkte me strategjitë ose planet e tjera zhvillimore për uljen e varfërisë në nivel kombëtar, duhet të bazohet në strategji nacionale reale dhe të përgatitura mirë për zhvillimin e statistikave (SNZhS) dhe duhet të përfshijë përkrahjen e harmonizuar dhe të koordinuar të donatorëve, sipas parimeve të përcaktuara qartë. Në veçanti, përkrahja e donatorëve në ndërtimin e kapacitetit statistikor duhet të ofrohet në përputhje me Deklaratën e Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës.** Në pjesën tjetër të dokumentit theksohet se çfarë ka mundësi të përfshihet në procesin e rritjes së përkrahjes në statistikë duke aplikuar një qasje që shtrihet në gjithë sistemin, ngjashëm me qasjet sektoriale që tashmë janë aplikuar në sektorin e shëndetësisë, arsimin dhe bujqësinë. Gjithashtu, theksohet se çfarë duhet të bëhet nga vendet në zhvillim dhe nga donatorët për të realizuar praktikisht këto qasje. Një parakusht kyç për aplikimin e qasjes që shtrihet në gjithë sistemin do të jetë strategjia nacionale gjithëpërfshirëse, me prioritete të përcaktuara për investim, zhvillimi i resurseve njerëzore dhe ndryshimi i politikës.

Në aneksin 1 paraqiten parimet kryesore të Deklaratës së PARIS dhe mënyrat se si mund të aplikohen këto parime në statistikë. Termi sistem statistikor nacional i referohet gjithë procesit të grumbullimit, përpunimit, diseminimit dhe shfrytëzimit të statistikave, të hartuara nga agjensitë qeveritare. Ai do të përfshijë jo vetëm aktivitetet e agjensisë statistikore qendrore, por edhe statistikën mbi shëndetësinë, arsimin, bujqësinë, regjistrimin e popullsisë, financat dhe ekonominë, të përgatitura nga ministritë relevante, bankat qendrore dhe agjensitë e tjera qeveritare. Statistikat më zyrtare financohen nga të ardhurat nga tatimet dhe përpilohen nga agjensi shtetërore. Megjithatë, në disa shtete këto aktivitete do të plotësohen nga aktivitetet e organizatave hulumtuese, asociacionet tregtare dhe të tjera.

Strategjitë nacionale për zhvillimin e statistikave

Gjatë procesit të përgatitjes së një strategjie nacionale për zhvillimin e statistikave, vendet në zhvillim deklarohen që ky proces nuk është një biznes në kuptimin e zakonshëm të fjalës. Një SNZhS e përgatitur si duhet ka të bëjë me tërë sistemin statistikor nacional- duke përfshirë statistikën e krijuara dhe të shfrytëzuara nga ministritë relevante, si shëndetësia, arsimi, bujqësia etj. – dhe jo vetëm një grup të dhënash ose të dhëna të përgatitura vetëm nga një agjensi. Ajo ka të bëjë edhe me çështje teknike statistikore dhe kapacitetin institucional dhe të resurseve njerëzore, dhe, më e rëndësishmja, duhet të jetë reale dhe e realizueshme duke identifikuar prioritetet në përputhje me nivelin e resurseve që janë në dispozicion (*shih tabelën 1*)

Vendet që kanë përgatitur një strategji nacionale të mirë, ose që janë në proces të përgatitjes së saj, kanë krijuar bazën për një program të suksesshëm implementimi. Proceset në të cilat bazohet kjo strategji janë shumë të ngjashme me ato që janë shfrytëzuar për përgatitjen e strategjive për uljen e varfërisë. E përbashkëta e të gjithave është që qasja e tyre është afatmesme deri në afatgjate dhe bazohet në vlerësimin e nevojave dhe prioriteteve, duke përfshirë në proces të gjitha subjektet relevante. Ajo që duhet të kuptohet në këtë moment është mënyra si të aplikohet kjo qasje në fushën e statistikës, të identifikohet se çfarë kërkohet nga partnerët kryesorë, sidomos agjensitë statistikore të vendeve zhvillim dhe donatorët, dhe të ndërtohet mbi atë që është arritur deri tani.

Tabela 1: Një Strategji Nacionale për Zhvillimin e Statistikave duhet:
1. Të jetë nën udhëheqjen dhe pronësinë e institucioneve vendore, me përkrahje të lartë politike
2. Të jetë e përqëndruar në nevoja dhe e integruar në politikat e zhvillimit nacional, duke marrë në konsideratë angazhimet regjionale dhe ndërkombëtare të shteteve
3. Të hartohet në mënyrë përfshirëse dhe konsultative
4. Të vlerësojë nevojat e të gjithë sektorëve statistikorë dhe shfrytëzuesve të të dhënave dhe të ofrojë një vizion dhe plan strategjik për statistikën nacionale
5. Të përcaktojë një program për zhvillimin e statistikave, me prioritete dhe afate kohore, për ndërtimin e kapaciteteve për arritjen e rezultateve, duke inkorporuar planet për implementim, monitorim dhe vlerësim, por gjithashtu të jetë fleksibil në rast ndryshimi.
6. Të adresojë pengesat dhe proceset institucionale dhe organizative, duke përfshirë resurset, për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemeve statistikore dhe rezultateve
7. Të aplikojë 'përshtatjen ndaj qëllimit' duke mësuar nga përvojat dhe standardet ndërkombëtare
8. Të ndërtojë mbi atë që është bërë dhe vazhdon të bëhet dhe të vazhdojë të plotësojë nevojat imediate të sistemit
9. Të reagojë ndaj nevojave të shfrytëzuesve, por të jetë reale në raport me resurset
10. Të shërbejë si kornizë koherente për përkrahjen ndërkombëtare në zhvillimin e statistikave dhe programeve statistikore në Sistemin Statistikor Nacional

Si mund të aplikohet në praktikë qasja që shtrihet në tërë sistemin?

Në kuptimin formal, statistikën zyrtare dhe aktivitetet shoqëruese të mbledhjes, përpunimit, shfrytëzimit dhe diseminimit të të dhënave mbi kushtet sociale dhe ekonomike në një vend, normalisht nuk konsiderohen si një sektor i vetëm. Ato shikohen si pjesë e një programi aktivitetesh, që kryhen në disa sektorë. Përveç kësaj, procesi i përgatitjes së strategjisë statistikore, që mbulon të gjithë, ose të paktën pjesët kryesore, të një sistemi statistikor nacional, ofron një kornizë në kuadër të së cilës mund të përdoret qasja e bazuar në gjithë sistemin ose qasja e bazuar në program për ofrimin e asistencës teknike dhe financiare të koordinuar dhe të harmonizuar.

Në përgjithësi, aplikimi i kësaj qasjeje në statistikë përfshin aplikimin e planit ose strategjisë nacionale si kornizë për koordinimin mes sektorëve dhe mes donatorëve, duke bërë kështu që përkrahja e donatorëve të jetë koherente, dhe kostot e transaksionit më të vogla duke caktuar objektiva dhe rezultate që synohen të arrihen, si dhe duke vendosur mekanizma të përbashkët për implementim, monitorim të progresit dhe raportim. Vetë qasja nuk ofron ose kërkon një mekanizëm të ri për ofrimin e asistencës nga donatorët.

Janë disa mënyra financimi, që mund të përdoren,

duke përfshirë financimin tradicional të projekteve, bashkimin e fondeve dhe përkrahjen e buxhetit, ose kombinimi i këtyre. Donatorët mund të vazhdojnë të përkrahin programe individuale, si statistikave ekonomike ose sistemet e informimit shëndetësor, ose aktivitete të mëdha si regjistrimi i popullsisë. E rëndësishme është që të gjitha këto ndihma të përputhen me strategjinë nacionale për statistika. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet që implementimi mund të marrë vite të tëra dhe mund të përfshijë më shumë se një fazë financimi nga donatorët. Është e qartë që përkrahjet nga burime të ndryshme do të kenë orare të ndryshme kohore, varësisht nga ciklet e financimit të donatorëve. Megjithatë, esenciale janë vazhdimësia dhe parashikueshmëria e fondeve.

Si mund të funksionojë qasja që shtrihet në tërë sistemin?

Një strategji e mirë nacionale është padyshim një parakusht i nevojshëm për një qasje të koordinuar në zhvillimin e statistikave, por jo dhe i mjaftueshëm. Ka edhe faktorë të tjerë në nivel shtetëror që janë shumë të rëndësishëm:

□ **Pronësi dhe lidhshmëri e qartë e shtetit dhe qeverisë** – edhe pse udhëzuesit mbi SNZhS theksojnë rëndësinë e pronësisë dhe lidhshmërisë të shtetit, presioni mbi shtetin për hartimin e një strategjie ka çuar, në disa raste, në hartimin e planeve dhe dokumenteve të izoluara nga programi i gjithëmbarshtëm për zhvillimin e vendit dhe pa lidhje të qarta me strategjitë për uljen e varfërisë dhe dokumentet e tjera mbi politikën. Ka raste kur SNZhS është hartuar nga një agjensi statistikore nacionale pa mandat të qartë dhe pa u konsultuar me subjektet e tjera relevante. Shpesh, dokumentet janë përgatitur nga konsulentë dhe vetëm në stadin e fundit të këtij procesi është kërkuar përkrahje nga niveli i lartë. Në përgjithësi, qasja që shtrihet në tërë sistemin ka mundësi të jetë efektive atëherë kur iniciativa për përgatitjen e një SNZhS lind brenda qeverisë, në nivel të lartë, dhe ku procesi ka mandat të qartë.

□ **Përfshirja e të gjithë donatorëve** – në sektorët e tjerë, sidomos në vendet me kapacitet të kufizuar menaxhues, është konsideruar e dobishme që një donator, aktiv në sektorin në fjalë, të luajë rolin udhëheqës. Kjo mund të përfshijë përkrahjen e hartimit të politikës dhe strategjisë, ofrimin e ndihmës në koordinimin dhe ndërveprimin në mes të qeverisë dhe donatorëve, dhe sigurimin e disa fondeve. Ka mundësi që një rol i tillë të jetë i rëndësishëm edhe në fushën e statistikës, dhe më i dobishëm atëherë kur donatori kryesor ka ekspertizë në statistikave zyrtare dhe sistemet statistikore nacionale. Por, në mënyrë që qasja të jetë efektive, pjesëmarrja aktive e të gjithë donatorëve të përfshirë në fushën e statistikës në një vend është e rëndësishme, duke përfshirë identifikimin e asistencës që aktualisht ofrohet nga donatorët, ose planifikohet të ofrohet nga ta. Në disa vende, sidomos gjatë përgatitjes për herë të parë të planit të tyre strategjik, donatorët e tjerë kanë qenë të përfshirë në fazat e fundit, p.sh. duke marrë pjesë në takimet e organizuara për të diskutuar produktin final. Si rezultat, strategjia është konsideruar si produkt i një donatori kryesor dhe në këtë rast partnerët e tjerë mund të kenë pak interesim dhe pronësi mbi strategjinë. Kjo qasje do të duhej të diskutohej nga një komitet për koordinimin e donatorëve dhe/ose të jetë pjesë e agjendës së grupit të donatorëve, që janë të pranishëm në vend.

□ **Integrimi i planit statistikor me planifikimin nacional dhe proceset rreth buxhetit** - Kjo tashmë është identifikuar si prioritet për financimin e zhvillimit të statistikave në përgjithësi, por ka edhe më shumë rëndësi kur bëhet fjalë për efektivitetin e qasjes së bazuar në tërë sistemin. Qartësimi i shpenzimeve dhe resurseve për statistika, duke përfshirë veprimet prioritare që duhet të ndërmerren për arritjen e rezultateve, është një komponent esencial. Planet e përgatitura pa marrë në konsideratë resurset e kufizuara ka pak mundësi të jenë reale ose të realizueshme. Gjithashtu, është e rëndësishme të dakordohen nevojat për financim afatgjatë për të siguruar që realizohen kthimet nga investimet dhe që përmirësimet e performancës janë të qëndrueshme. Çështja e realizueshmërisë dhe qëndrueshmërisë do të jetë kyçe për implementimin e SNZhS. Sigurimi i qëndrueshmërisë arrihet përmes konsultimit të të gjitha subjekteve relevante (sidomos politikë-bërësit e nivelit të lartë dhe donatorët). Kostoja e planit duhet të jetë reale, as shumë e lartë dhe as shumë e ulët. Qëndrueshmëria do të varet nga ndërtimi efektiv i kapaciteteve dhe fuqia e SNZhS, si dhe nga regjimet e ndryshme politike dhe financiare.

□ **Të siguruarit që SNZhS definon dhe ka të bëjë me gjithë sistemin e gjerë statistikor** – Në mënyrë që qasja të jetë më efektive, ajo duhet të përfshijë më shumë se vetëm një agjensi qendrore, qoftë edhe në një sistem statistikor të centralizuar. Edhe pse shpesh është e vështirë të definohen saktësisht kufinj të një sistemi statistikor, është e rëndësishme të përfshihen, në stadin e hershëm, agjensitë që janë përgjegjëse për të dhëna kyçe (p.sh. ministritë që janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve, si shëndetësia, arsimiti, uji/infrastruktura). Kjo mund të përfshijë, p.sh., aktivitete si regjistrimi i ngjarjeve vitale, që nuk përfshihen gjithmonë në përkufizimet e statistikave zyrtare. Me përfshirjen vetëm të agjensisë qendrore statistikore, do të jetë e vështirë të sigurohet përkushtim dhe përkrahje e gjerë për statistika – duke siguruar koherencë në sistemin statistikor nacional- me përfshirje të të gjithë donatorëve relevantë. Ministritë janë gjithashtu shfrytëzuese të statistikave, por shpesh kanë interaksion të dobët me agjensinë statistikore qendrore: nevojat e tyre duhet të kenë më shumë prioritet në SNZhS. Gjithashtu, duhet të merret parasysh ndihma ekzistuese dhe ajo e planifikuar e donatorëve në gjithë sistemin statistikor nacional.

□ **Të siguruarit që SNZhS identifikon rezultatet kryesore dhe aplikon parimin e 'përshtatjes ndaj qëllimit'** – SNZhS duhet të ofrojë një platformë reale për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të statistikave nacionale, dhe adresimin e nevojave imediate për të dhëna për progresin e zhvillimit. Ajo duhet të identifikojë rezultatet kryesore statistikore dhe mekanizmat e arritjes së tyre, të përcaktojë një program të anketimeve dhe regjistrimeve të popullsisë, të bëjë analiza dhe të caktojë afate për nxjerrjen e të dhënave, të zhvillojë më tej atë që është bërë deri tani, të përfshijë programe teknike për ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe të resurseve njerëzore, të shoqëruara me avokim të vazhdueshëm dhe produktiv dhe strategji për mbajtjen e lidhjeve me shfrytëzuesit e të dhënave dhe financuesit.

□ **Sigurimi i kapacitetit adekuat për koordinim dhe menaxhim** – Edhe në një sistem të centralizuar statistikor, ka disa agjensi të ndryshme, që janë të përfshira në prodhimin dhe shfrytëzimin e statistikave zyrtare. Pothuaj në të gjitha vendet, agjensia statistikore qendrore luan rolin udhëheqës në hartimin e SNZhS dhe koordinimin e sistemit statistikor nacional. Edhe në qasjen e shtrirë në tërë sistemin, kjo agjensi do të

ketë rolin udhëheqës në aspektin teknik dhe profesional, duke menaxhuar në të njëjtën kohë një proces të ndërlikuar ndryshimi intern. Do të jetë e rëndësishme të sigurohet që agjensia statistikore qendrore ka kapacitet për të menaxhuar ndryshimin dhe për t' u ofruar lidhshmëri departamenteve dhe agjensive të tjera, që gjithashtu duhet të kenë kapacitetin e duhur menaxhues. Duhet të formohen struktura për koordinim – si Këshilli Statistikor Nacional – për të siguruar koordinimin e duhur në mes të prodhuesve të ndryshëm të të dhënave dhe ndërveprimin me shfrytëzuesit e të dhënave dhe vendimmarrësit. Duhet të përcaktohen procedurat dhe lidhjet në mes të këtij Këshilli dhe komitetit për koordinimin e donatorëve.

□ **Përcaktimi i strukturave dhe procedurave uniforme të implementimit** – ka mundësi që, duke pasur disa agjensi implementuese potenciale, donatorë dhe mekanizma të ndryshëm financimi, qasja e shtrirë në të sistemin të jetë mjaft e ndërlikuar. Është e zakonshme që të sigurohen struktura efektive për implementim dhe që të vendosen procedura të detajuara të prokurimit, menaxhimit financiar dhe monitorimit para fillimit të implementimit, duke u bazuar në një kornizë ose dokument mbi projektin, të dakorduar paraprakisht. Gjithnjë e më shumë, këto procese duhet të bazohen në procedurat vendore/lokale. Ka mundësi që shumë vende do të kenë nevojë për përkrahje dhe këshilla teknike për të realizuar këtë në fushën e statistikës.

□ **Vendosja e mekanizmave të përshtatshëm financiarë** – janë tre mekanizma kryesorë për financimin e kësaj qasjeje; secili nga ta ka disa përparësitë dhe mangësitë e veta, por zgjedhja finale do të varet përfundimisht nga rrethanat në vend:

1. Bashkimi i të gjitha fondeve – ndoshta është zgjidhja më e mirë në kuptimin e koordinimit dhe monitorimit, duke qenë marrësi i ndihmës përgjegjës për administrim dhe raportim;
2. Bashkimi i disa fondeve të donatorëve, me kontribute të tjera që menaxhohen veçmas; dhe
3. Financimi paralel ku partnerët bëjnë marrëveshjet me marrësin. Kjo i jep më shumë fleksibilitet donatorit dhe marrësit, por koordinimi i fondeve dhe i aktiviteteve mund të jetë më i vështirë.

□ **Koordinimi i asistencës teknike** – përveç financimit të investimeve në infrastrukturë, shumë vende do të kenë nevojë për asistencë teknike në mënyrë që të përmirësojnë fushën e statistikave dhe të menaxhojnë ndryshimet. Rritja e përkrahjes në statistikë do të kërkojë përkrahje teknike dhe koordinim më efektiv mes ofruesve të kësaj përkrahjeje. Aranzhimi i "binjakëzimit", ku një agjensi e caktuar statistikore i ofron përkrahje teknike një sistemi të caktuar statistikor-marrësi, mund të jetë efektive për fushat me ekspertizë të pamjaftueshme. Një mënyrë tjetër mund të jetë qëndrimi i një statisticienti në vend për përkrahjen e sistemit statistikor nacional.

Ku mund të të aplikohet qasja e bazuar në tërë sistemin?

Do të varet nga vetë shtetet dhe partnerët e tyre në zhvillim nëse një qasje e bazuar në tërë sistemin është e përshtatshme për nevojat e tyre, por mund të jetë e dobishme që të identifikohen kriteret, që tregojnë se ku mund të ketë sukses kjo qasje. Në përgjithësi, shanset për sukses janë në vendet ku është e qartë se ka

nevojë për përmirësim, ku është përgatitur ose është duke u përgatitur një strategji ose një plan i saktë nacional për statistika, ku ka kërkesa dhe përkrahje për statistika nga vetë qeveria, dhe ku ka kapacitet të mirë menaxhues. Por, është e rëndësishme të dihet se vendimet për alokimin e resurseve merren gjatë proceseve të ndryshme duke përfshirë, në anën e donatorëve, zgjedhje politike dhe strategjike, anëtarësimin e shteteve në grupime regjionale, identifikimin e nevojave dhe ndikimit të pritur. Ka disa kritere, të ndërlidhura mes vete, që mund të përdoren për të identifikuar vendet ku nevojiten përpjekje më intensive dhe më të harmonizuara për përkrahjen e ndërtimit të kapacitetit statistikor, duke siguruar gjithashtu që këto vende të jenë nga regjione të ndryshme gjeografike me qëllim të zgjerimit të ndikimit. Këto kritere janë indikative dhe vetëm disa vende mund t'i përmbushin të gjitha. Përveç kësaj, marrja në konsideratë e këtyre kritereve mund të ndihmojë shtetet dhe partnerët e tyre në zhvillim të vendosin se a i përshtatet kjo qasje nevojave të tyre. Këto kritere janë:

□ **Vendet me sisteme statistikore më pak të zhvilluara** – Ka shumë faktorë, që i kontribuojnë zhvillimit më të pakët të sistemit statistikor, por një mënyrë e identifikimit të atyre vendeve që kanë nevojë më së shumti për përmirësime në fushën e statistikës, do të ishte të shikohej ekzistimi dhe shtrirja e aktiviteteve kyçe, si Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare, regjistrimi i popullsisë dhe indikatorët për qëllimet zhvillimore të mileniumit.

□ **Vendet me potencial për ndikim të lartë (ato që kanë strategji ose plan të mirë)** – Pasja e një plani statistikor është një kriter i qartë, por e rëndësishme është të vlerësohet cilësia e planit si bazë për aplikimin e qasjes që shtrihet në tërë sistemin. Gjithashtu, prioritetet do të kenë vendet që kanë të drejtë të huazojnë ose të marrin grante nga Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA).

□ **Vendet, ku ka nevojë të lartë për përmirësimin e kapacitetit statistikor** – Indikatorët e përkushtimit ndaj përmirësimit të statistikave janë inkorporimi i strategjisë statistikore në strategjinë për uljen e varfërisë ose strategjinë për zhvillim, paraqitja e nevojës nga vendi për përkrahje më intensive nga donatorët, dhe përkushtim i lartë i qeverisë, p.sh. në kuptimin e kontributit buxhetor në fushën e statistikës.

□ **Vendet me kapacitet të mirë menaxhues** – Kriteret për të përcaktuar një gjë të tillë mund të jenë: kapaciteti për të absorbuar asistencën intensive të ofruar nga donatorët dhe ekzistimi i mekanizmave të udhëhequr nga vetë shteti për koordinimin e asistencës eksterne. Gjithashtu është i rëndësishëm kapaciteti i vendit për të monitoruar dhe raportuar mbi implementimin e planit.

□ **Vendet e zgjedhura si prioritet nga partnerët e zhvillimit** – edhe pse vendet prioritare mund të identifikohen me anë të analizave sistematike të nevojave ose institucioneve të tyre, përzgjedhja e vendeve mund të varet nga vendime politike të partnerëve për zhvillim. P.sh. donatorë të caktuar kanë tendencë të përqëndrohen në vende të caktuara për arsye historike, gjeografike, humanitare e të tjera. Këta faktorë do të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në përzgjedhjen e vendeve prioritare dhe nuk duhen injoruar. Një mënyrë është të shkëmbehen më shumë informacione për programe të ndryshme, me detaje rreth marrësit të përkrahjes, llojit të përkrahjes dhe fushat e aktiviteteve.

Por, më e rëndësishmja është se edhe vendet edhe donatorët duhet të jenë të përkushtuar që ta bëjnë këtë më së miri duke vepruar në përputhje me rrethanat aktuale dhe duke marrë parasysh pengesat që u kanosen. Disa aspekte të kësaj qasjeje mund të ecin përpara më shpejt se disa të tjera – p.sh. koordinimi më i mirë i përkrahjes së donatorëve duhet të fillojë sa më shpejt që është e mundur në të gjitha vendet – përderisa për aspekte të tjera fillimisht duhet të ndërtohen kapacitetet, p.sh. kapaciteti për të menaxhuar një qasje të tillë.

Çfarë duhet të bëhet?

Në mënyrë që të aplikohet qasja që bazohet në gjithë sistemin për të përkrahur implementimin e SNZhS, duhet të ndërmerren disa veprime. E para, ekziston nevoja për udhëzime dhe asistencë tjetër për vendet që duan të zhvillojnë fushën statistikore. Fusha të veçanta fokusi do të ishin: të kuptuarit e mekanizmave financiarë, zhvillimi i strukturave menaxhuese të përshtatshme dhe efektive, të kuptuarit e vlerësimit vjetor dhe ciklit të planifikimit, zhvillimi i kapacitetit për menaxhim financiar dhe prokurim, caktimi i afateve kohore, mekanizmave të monitorimit dhe raportimit. Si hap i parë, mund të nxirren mësim nga shembujt ose rastet ekzistuese dhe të shpërndahen ato. Në disa vende, gjatë hartimit të SNZhS dhe përgatitjes së programeve të donatorëve për financimin e implementimit të saj është aplikuar qasja e bazuar në program dhe është e rëndësishme të dokumentohen këto procese dhe të mësohet nga to. Shembuj të mirë ka në Kenia, Tashkistan, dhe Uganda (shih tabelën 2). Këta dhe shembuj të tjerë të aplikimit të qasjes së bazuar në tërë sistemin mund të përdoren për të testuar realizueshmërinë dhe sfidat- p.sh. në arritjen e marrëveshjes me subjektet relevante- dhe për të nxjerrë mësim që mund të aplikohen më gjerë. E dyta, donatorët dhe përfaqësuesit e shteteve duhet të përcaktojnë kriteret për identifikimin e vendeve, në të cilat mund të jetë i përshtatshëm aplikimi i kësaj qasjeje dhe ku ka nevojë për përkrahje më intensive nga donatorët. Ky proces mund të përfshijë monitorimin e kapacitetit statistikor në këto vende dhe azhurnimin e rregullt të të dhënave të fituara, p.sh. përmes publikimit të një buletini. Deri tani nuk ka shumë informatata për nevojat prioritare të shteteve dhe progresin e tyre drejt përmirësimit të kapacitetit statistikor. Koordinimi i një aktiviteti të tillë në nivel global nga donatorët dhe agjensitë ndërkombëtare do të jetë esenciale për përkrahjen e rritjes së investimeve në vende të caktuara.

E treta, shumë vende do të kenë nevojë për ndihmë me qëllim që të përmbushin kriteret për aplikimin e qasjes në fjalë. P.sh. mund të kenë nevojë për asistencë në bashkëpunimin dhe koordinimin e donatorëve, ose mekanizmat e financimit të përbashkët të donatorëve, kurse disa vende mund të kenë kufizime në aspektin e menaxhimit. Në disa raste, derisa zhvillimi i qasjes që shtrihet në gjithë sistemin do të ishte objektiv afatmesëm, mund të jetë e nevojshme të konsiderohet procesi i përforsimit të kapaciteteve për një afat të shkurtër kohor. Kjo mund të arrihet përmes projekteve afatshkurta deri në ato afatmesme, të cilat përqëndrohen në fusha prioritare, që nuk kërkojnë legjislacion të ri ose reforma të mëdha administrative, dhe që ndihmojnë në arritjen e rezultateve të shpejta dhe zhvillojnë kapacitetin implementues.

Tabela 2. Aplikimi i qasjes në tërë sektorin në Taxhikistan

Qeveria e Taxhikistanit ka hartuar një plan statistikor shumë vjeçar, të integruar, me përkrahjen financiare të Fondit të Mirëbesimit të Bankës Botërore dhe bashkëfinancim nga donatorë të tjerë, duke përfshirë programin STATCAP të Bankës Botërore. Karakteristikat kryesor të këtij procesi ishin:
<input type="checkbox"/> Plani u zhvillua me qëllimin e qartë që të implementohet. U caktuan prioritetet, kostoja, dhe forma e implementimit ishte e qartë dhe e realizueshme;
<input type="checkbox"/> Plani mbulonte të gjithë sistemin statistikornacional, dhe jo vetëm ato aktivitete që janë nën kontrollin direkt të zyres statistikore;
<input type="checkbox"/> Plani është në përputhje me strategjinë për zhvillimin e përgjithshëm nacional në Taxhikistan;
<input type="checkbox"/> Ka përkrahje të madhe politike për zhvillimin e statistikave;
<input type="checkbox"/> Ka një donator kryesor/udhëheqës (në këtë rast Banka Botërore), i cili ndihmon koordinimin e aktiviteteve të donatorëve dhe komunikimin në mes të agjensive kryesore qeveritare;
<input type="checkbox"/> Janë zhvilluar konsultime në fazën e hershme me subjektet dhe donatorët kryesorë relevantë – donatorët janë shumë të interesuar për zhvillimin e fushës së statistikës;
<input type="checkbox"/> Orari i projektit STATCAP iu përshtat programit të donatorit kryesor në vend dhe projekti u përfshi në raportin mbi Strategjinë për Asistencë në vend;
<input type="checkbox"/> Tranzicioni nga kompletimi i Programit Statistikor Shumëvjeçar të Integruar (MISP) në kompletimin e projektit STATCAP ishte i lehtë dhe u kap moment i duhur;
<input type="checkbox"/> Implementimi realizohet përmes një konsorciumi të përbërë nga pesë agjensi statistikore evropiane, që është formuar sipas procedurave standard kompetitive të Bankës Botërore.

E katërta, vendet (dhe donatorët) duhet të shfaqin përkushtimin e tyre ndaj këtij procesi.

Kur bëhet fjalë për vendet, kjo përfshin këto parakushte:

- Është përgatitur, ose është duke u përgatitur, një strategji e mirë statistikore me përkrahjen e nivelit të lartë politik;
- Ministri i financave ose ministri përgjegjës i dërgon një kërkesë komunitetit të donatorëve ku kërkon përkrahje në implementimin e strategjisë nacionale për zhvillimin e statistikave dhe propozon aplikimin e qasjes së bazuar në program.
- Resurset e nevojshme janë identifikuar, ose do të identifikohen, në kornizat nacionale për resurse, si kornizat mbi shpenzimet afatmesme
- Janë hapur bisedimet me përfaqësues të donatorëve lokalë
- Të gjithë donatorë (ose së paku donatorët kryesorë) që kanë interes në përkrahjen e statistikave kanë rënë dakord për këtë qasje dhe njëri donator është identifikuar si udhëheqës i procesit të koordinimit dhe bisedimeve me qeverinë
- Janë identifikuar iniciativat ekzistuese në fushën e statistikës dhe është e qartë mënyra se si do të përfshihen ato në qasjen e bazuar në programe.

E pesta, duhet të zgjerohet rrethi i statistikentëve me përvojë dhe specialistëve të tjerë, që mund të ofrojnë përkrahje teknike dhe përkrahje në zhvillimin institucional dhe organizativ për vendet në zhvillim me qëllim të dizajnit, dhe sidomos implemmentimit, të SNZhS dhe programeve të tjera shoqëruese të reformës.

Rëndësi të veçantë do të ketë zhvillimi i ekspertizës në vetë vendet në zhvillim dhe promovimi i përkrahjes teknike nga zyret statistikore nacionale dhe burimet e tjera të ekspertizës. Qendrat regjionale të trajnimit do të luajnë rolin e tyre në përkrahjen e zhvillimit profesional dhe aftësimin e statistikentëve dhe ekspertëve të tjerë lidhur me zhvillimin e organizatave dhe ofrimin e konsulencës. Qendrat regjionale të ekselencës për aspekte të veçanta të statistikës do të luani një rol kyç në ofrimin e asistencës teknike. Ekspertiza e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (ang. OECD) do të jetë e nevojshme për ofrimin e përkrahjes mes vendeve të ndryshme, duke përfshirë trajnimin e trajnerëve dhe përkrahjen e qendrave regjionale. Kjo do të kërkojë një angazhim më të madh të sistemeve statistikore nacionale të vendeve në kuadër të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, dhe mund të ketë nevojë që të zgjerohet rrethi i specialistëve që mund t'i ofrojë asistencë statistikentëve, menaxherëve në statistikë dhe profesionistëve të tjerë. Siç u tha më parë, procedura e binjakëzimit, që nënkupton sigurimin e qëndrueshëm të ekspertizës nga sistemet statistikore të vendeve të zhvilluara, është shumë e rëndësishme dhe duhet të zgjerohet. Donatorët duhet të rrisin kapacitetet e tyre dhe qasjen në ekspertizë në mënyrë që të kuptojnë dhe t'i kontribuojnë programeve për zhvillimin e kapaciteteve statistikore, duke pasur parasysh që kjo është një fushë e re dhe shumë e rëndësishme (për shumë donatorë). E gjashta, do të duhen procedura të veçanta për të përkrahur vendet me nevoja të veçanta, sidomos ato që kanë dalë nga konflikti dhe vendet e vogla me popullsi më pak se 0.5 milion. Vendet e dala nga konflikti kanë nevoja të veçanta dhe kapacitete të kufizuara për përgatitjen e një strategjie nacionale ose edhe për të realizuar aktivitetet themelore statistikore. Prandaj, nevojitet asistencë teknike dhe financiare e konsiderueshme për të rivendosur kapacitetet për të filluar realizimin e programeve statistikore, ku prioritet mund të jetë regjistrimi i popullsisë dhe krijimi i statistikave themelore ekonomike dhe sociale. Meqenëse procesi i ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore merr kohë, kjo lloj asistence direkte duhet të zgjasë disa vite. Megjithatë, qëllimi afatmesëm do të duhej të ishte përgatitja e një SNZhS dhe orientimi drejt qasjes që shtrihet në tërë sistemin për financimin e ndërtimit të mëtejshëm të kapaciteteve. Vendet me numër të vogël të popullsisë, përballen me shumë probleme në zhvillimin e sistemeve statistikore. Ato përballen me kosto më të larta per capita në krahasim me vendet e tjera dhe resurset njerëzore të tyre janë më të kufizuara. Prandaj, në këto vende, përkrahja në fushën e statistikës duhet të jetë më e madhe se në vendet e tjera, madje edhe ato që bëjnë pjesë në kategorinë me të ardhura mesatare. Megjithatë ekziston mundësia e ofrimit të përkrahjes në baza nënregjionale, ku vendet punojnë së bashku në koordinimin e SNZhS dhe planeve të tyre të implementimit. Pra, duhet të shqyrtohet se si mund t'u ofrohet përkrahje efektive këtyre vendeve. Hapat e ardhshëm të propozuar paraqiten në vazhdim:

1. **Vazhdimi i diskutimit në nivel të lartë** në seminarin e nëntorit të vitit 2007 në Paris, në takimin e nivelit të lartë të Komitetit të Asistencës për Zhvillim të dhjetor të vitit 2007 dhe në forumin e tretë të nivelit të lartë mbi Efektivitetin e Ndhmës, që do të mbahet në Ganë në shtator të vitit 2008.

2. **Identifikimi shteteve** ku do të ishte i përshtatshëm aplikimi i qasjes së shtrihet në tërë sistemin. Të gjitha vendet duhet të inkurajohen që të shprehin interesimin e tyre, por fazat e zhvillimit të këtij procesi do të vareshin nga kriteret e përcaktuara më lart.

3. **Përgatitja e materialeve udhëzuese dhe mbi praktikat e mira** lidhur me atë se si mund të implementohet SNZhS duke aplikuar qasjen në fjalë. Drafti i parë do të jetë i gatshëm në mes të shtatorit, kurse drafti final në fund të tetorit të vitit 2007.

4. **Takimet e subjekteve relevante në nivel shtetëror** (duke përfshirë shfrytëzuesit e të dhënave, prodhuesit e të dhënave, financierët dhe donatorët potencialë). Pasi të kenë adaptuar vendet këtë qasje, PARIS21 do të punojë me to rreth realizimit të takimeve të subjekteve relevante në vend.

5. **Përmirësimi i monitorimit** të kapacitetit statistikor të vendeve dhe i përkrahjes në ndërtimin e kapaciteteve statistikore.

Aneksi 1: Aplikimi i Deklaratës së Paris mbi Efektivitetin e Ndhmës në Financimin e Investimeve në Statistikë

Deklarata e Paris mbi Efektivitetin e Ndhmës, e miratuar më 2 mars të vitit 2005, është një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar nga mbi njëqind ministri, udhëheqës agjensish dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Ata u përkushtuan për menaxhim, harmonizim dhe përputhshmëri më të madhe të programeve të tyre të ndihmës me qëllim të arritjes së rezultateve të matshme duke ndërmarrë veprime të monitorueshme dhe duke shfrytëzuar indikatorë për matjen e progresit. Në veçanti, Deklarata i obligon nënshkruesit e saj për pesë parime kryesore:

- Pronësia, ku vendet partnere ushtrojnë lidhshëm mbi politikën dhe strategjinë zhvillimore dhe koordinonë në mënyrë aktive aktivitetet zhvillimore;
- Përputhshmëria, ku donatorët bazojnë përkrahjen e tyre të përgjithshme në institucionet, procedurat dhe strategjinë zhvillimore nacionale të vendeve në fjalë;
- Harmonizimi, për të siguruar që aktivitetet e donatorëve janë më të harmonizuara, më transparente dhe më efektive në kuptimin kolektiv;
- Menaxhimi i rezultateve, që nënkupton përmirësimin e vendimmarrjes dhe të resurseve me qëllim të arritjes së rezultateve të matshme; dhe
- Llogaridhënia reciproke, për të siguruar që donatorët dhe partnerët janë përgjegjës për rezultatet zhvillimore.

Është e qartë që statistikën janë të rëndësishme për implementimin dhe monitorimin e Deklaratës së Parisit në kuptimin që aktivitetet e sistemeve statistikore nacionale janë esenciale për përkrahjen e vendimmarrjes për arritjen e rezultateve zhvillimore dhe janë një nga mekanizmat kryesorë për monitorimin e progresit. Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme të shikohet se si mund të aplikohen këto parime në programe dhe projekte, që përkrahin ndërtimin e kapacitetit statistikor dhe, në veçanti, të sigurohet që ato përbëjnë bazën e çfarëdo iniciative që ka për qëllim rritjen e përkrahjes së donatorëve. Ka lidhje të forta në mes të Planit të Veprimit të Marrakech për Statistika, Parimeve të Statistikave Zyrtare të Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratës së Parisit. Me një fjalë, aplikimi i parimeve të Deklaratës së Paris në rritjen e investimeve në statistikë nënkupton të mëposhtmet.

- Pronësia nënkupton që vendet në zhvillim kanë pronësi dhe ushtrojnë lidhshëm mbi aktivitetet e tyre statistikore dhe donatorët e respektojnë këtë.
- Përshtatja e përkrahjes së donatorëve ndodh atëherë kur vendet në zhvillim përgatisin dhe implementojnë korniza strategjike dhe programe efektive për zhvillimin e statistikave nacionale (SNZhS ose dokumente të ngjashme) dhe kur donatorët ofrojnë përkrahje teknike dhe financiare brenda kontekstit të këtyre strategjive.
- Harmonizimi nënkupton që vendet në zhvillim të ushtrojnë lidhshëm mbi aktivitetet e tyre koordinimin e asistencës së donatorëve dhe donatorët të harmonizojnë aktivitetet e tyre përmes projekteve dhe programeve të planifikuara dhe të koordinuara si duhet.
- Menaxhimi për rezultate nënkupton që SNZhS duhet të dizajnohen jo vetëm për të siguruar të dhëna më të mira statistikore, dhe indikatorë, por gjithashtu për të siguruar që këto të dhëna ndihmojnë vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

□ Llogaridhënia reciproke nënkupton që vendet në zhvillim dhe donatorët të jenë dakord për monitorimin e implementimit dhe rezultateve të SNZhS brenda kontekstit të llogaridhënies reciproke, duke pasur parasysh që krijimi i një sistemi statistikor të qëndrueshëm mund të marrë kohë të gjatë. Të gjithë partnerët duhet të dakordohen rreth indikatorëve dhe afateve për monitorimin e realizimit të aktiviteteve, arritjes së rezultateve, ndikimit të statistikave më të mira dhe të sistemit statistikor më efektiv. Gjithashtu, duhet të arrihet një marrëveshje lidhur me qëllimet që duhet të arrihen dhe veprimet që duhet të ndërmerren kur implementimi nuk shkon si duhet.

Kontributi i partnerëve të ndryshëm në rritjen e përkrahjes në statistikë dhe aplikimi i këtyre parimeve përmbledhet në tabelën në vijim.

Partnerët	Nevojat	Rolet	Kontributet
Politikë-bërësit e vendeve në zhvillim	Statistika të cilësisë së mirë	Vendimet e bazuara në evidencë dhe financimi Shfrytëzimi i statistikave	Njohja e rëndësisë së statistikave Ofrimi i financimit të mjaftueshëm dhe të parashikueshëm Përkrahja e pavarësisë së agjensive statistikore
Statisticientët e vendeve në zhvillim	Statisticientë të kualifikuar, motivuar Përkrahje politike e nivelit të lartë Resurse, Standarde Asistencë teknike	Vizion dhe strategji për sistemin statistikor nacional Statistika relevante, të cilësisë së mirë	Përforcimi i lidërshpit dhe menaxhimit Koordinim më i mirë në sistemin statistikor nacional Implementimi i këshillave teknike relevante dhe i praktikave të mira
Politikë-bërësit dhe donatorët në vendet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim	Statistika të cilësisë së mirë	Vendime të bazuara në fakte Avokim për statistika Shfrytëzimi i dhënave Ndihmë financiare	Theksimi i rezultateve në programet e ndihmës. Të përqëndruarit në zhvillimin e kapacitetit statistikor dhe në nevojën për të dhëna Koordinim më i mirë i donatorëve Marrëveshje rreth asaj se si do të matet progresi
Statisticientët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim	Përkrahje nga agjensitë nacionale	Avokim për statistika zhvillimi i metodologjisë keshilla dhe trajnime	Paraqitja e rolit të asistencës teknike në objektivat e organizatave statistikore nacionale Identifikimi i i nevojave dhe

					mangësive të prodhuesve të dhënave
Politike-beresit nderkombetar/regjional dhe donatoret	Statistika cilësise se mire	te	Avokim statistikave Shfrytezimi statistikave Financimi	per	Përkrahja e rezultateve të programet e ndihmës Të përqëndruarit në zhvillimin e kapacitetit statistikor dhe në nevojën për të dhëna Koordinim më i mire i donatorëve
Statisticientet nderkombetare/ Regjionale	Statistika cilësisë së mire Resurset	të	Avokimi Standardet ndërkombëtare të dhëna nga vendet e krahasueshme Asistenca teknike	Të	përqëndruarit në ndërtimin e kapacitetit statistikor, si dhe nevojat imediate për të dhëna Të përqëndruarit në prioritetet nacionale Koordinim më i mire në mes të agjensive
Analistë, etj.	Statistika cilësisë së mirë	të	Ngritja e vetëdijes resurset teknike dhe financiare		Ndërveprim më i madh me prodhuesit e të dhënave dhe sistemet e qeverisjes

Aneksi 2: Çfarë është qasja e bazuar në programe ose qasja që shtrihet në të gjithë sektorin?

Qasja e bazuar në program dhe sektor ka disa vite që po aplikohet në fushat e shëndetësisë, arsimit dhe të bujqësisë. Një përkufizim i pranueshëm gjerësisht i kësaj qasjeje është se kjo paraqet një mekanizëm për financimin e përforsimit të kapacitetit dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimit në një sektor, ku *“... të gjitha fondet përkrahin politikën e një sektori të vetëm, nën udhëheqjen e qeverisë, duke adaptuar qasje të përbashkëta për tërë sektorin dhe duke u mbështetur në procedurat e qeverisë për shpenzimin e fondeve dhe llogaridhënies për to.”* Përkufizime të tjera të njohura janë: me këtë qasje mbulohet i gjithë sektori; një kornizë koherente e politikës; subjektet vendore udhëheqin procesin; përfshirje e të gjithë donatorëve, që janë të kyçur në sektor; aplikim i procedurave të përbashkëta të implementimit; dhe asistencë teknike afatgjate minimale. Edhe pse termat qasje që shtrihen në tërë sektorin ose qasje që shtrihen në tërë sistemin janë përdorur në sektorin e shëndetësisë ose arsimit, kohëve të fundit është përdorur termi qasje e

bazuar në program, sidomos për programe të gjera siç është zhvillimi rural. Deri tani, ky term nuk është aplikuar për projekte dhe programe që kanë për qëllim zhvillimin statistikor, edhe pse ka disa projekte që do të hynin pikërisht në kuadër të këtij përkufizimi. Brown dhe të tjerë theksojnë që, sipas përvojës, qasja që shtrihet në tërë sistemin është një *qasje* për financimin dhe implementimin e projekteve zhvillimore dhe jo vetëm qasje e një plani të thjeshtë.

Çfarë përfshin ky proces?

Praktikisht, procesi drejt qasjes së bazuar në program nënkupton formulimin e një strategjie, me kosto të përcaktuar dhe reale në kuptimin e resurseve që janë në dispozicion, dhe përgatitjen e një plani për implementim, në formë marrëveshjeje me burimin e fondeve, që përfshin edhe format e monitorimit të performancës. Zakonisht, këto aktivitete nuk ndodhin në formë lineare dhe disa prej tyre mund të zhvillohen paralelisht. Gjithashtu, është e rëndësishme të bëhet dallimi në mes të vetë qasjes, e cila ofron një bazë për raportet në mes të vendit dhe donatorëve, dhe aranzhimeve specifike të financimit. Shumë programe aktuale përfshijnë aranzhime të ndryshme financimi, që varen nga shkalla e konsensusit në mes të qeverisë dhe partnerëve të saj të zhvillimit, si dhe në mes të këtyre partnerëve mes vete, nga kostot dhe beneficionet e instrumenteve të ndryshme, nga kapaciteti i agjensive vendore për arritjen e rezultateve dhe llogaridhënia e këtyre agjensive para subjekteve të tyre relevante.

Është e rëndësishme të theksohet që implementimi mund të zgjasë me vite dhe mund të përfshijë më shumë se një fazë financimi nga donatorët. Nuk do të thotë që të gjitha fondet të ofrohen gjatë një periudhe; në fakt, ka më shumë mundësi që përkrahja nga donatorë të ndryshëm të ofrohet sipas orareve të ndryshme, varësisht nga ciklet e tyre të financimit. Ajo që është e rëndësishme është vazhdimësia dhe parashikueshmëria e fondeve. Përvojat e aplikimit të kësaj qasjeje në fushat e tjera tregojnë që është esenciale që të gjithë donatorët të përfshihen në statet e hershme të procesit dhe të marrin pjesë në zhvillimin dhe implementimin e strategjisë.

Cilat janë beneficionet?

Në përgjithësi, kjo qasje ka tendencën të përqëndrohet më shumë në rezultatet, që rrjedhin nga një proces i gjerë konsultimi. Beneficionet potenciale, që rrjedhin nga programe që shtrihen në tërë sektorin dhe që dizajnohen dhe implementohen me kujdes, janë këto:

- E para, pronësia dhe lidhëshmëria më e fortë e shtetit rrit mundësitë për të pasur sukses dhe përfitime, duke përfshirë qëndrueshmërinë institucionale.
- E dyta, aftësia për të tejkaluar çështjet kryesore me të cilat përballet sektori ndikon në alokimin më racional të resurseve.
- E treta, ka avantazhe të rëndësishme në kuptimin e efikasitetit, që rezultojnë nga raportimi i përbashkët, reduktimi i transaksioneve dhe i duplikimit.

Cilat janë kostot?

Qasjet e bazuara në programe ose në të gjithë sektorin padyshim janë më komplekse se projektet zhvillimore të ndara, dhe si të tilla kërkojnë më shumë kohë dhe punë. Kjo mund të ketë implikime të rëndësishme kur bëhet fjalë për arritjen e rezultateve të shpejta me qëllim të kapjes së momentit për realizimin e reformave.

Nevoja për të arritur një marrëveshje me subjektet relevante dhe të gjithë donatorët mund ta vështirësojë procesin konsultativ dhe të marrë kohë. Barra më e madhe bie mbi agjensinë kryesore qeveritare dhe kriteri kyç për arritjen e suksesit është që kjo agjensi të ketë kapacitetin e duhur për udhëheqjen e këtij procesi ose të ndihmohet në zhvillimin e këtij kapaciteti.